



INSTITUCIONET E PËRKOHSHME VETËQEVERISËSE NË KOSOVË INSTITUCIJE PRIVREMENE SAMOUPRAVE NA KOSOVU PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT OF KOSOVO		
QEVERIA E KOSOVËS Ministria e Shëndetësisë	GOVERNMENT OF KOSOVO Ministry of Health	VLADA KOSOVA Ministarstvo zdravstva

Udhëzimi Administrativ (shëndetësi) 18/ 2006

PËR DATABAZËN E SISTEMIT TË INFORMIMIT SHËNDETËSOR

Ministri i Ministrisë së Shëndetësisë

Në pajtim me autoritetin që i është dhënë Ministrisë së Shëndetësisë me rregulloren Nr. 2002/5 të dates 04 Mars 2002 (Ndryshim i Rregullores së mëparshme të UNMIK-ut Nr. 2001/19 mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetqeverisjes në Kosovë) posaqerisht me shtojcën VI, paragrafin (i) që e autorizon Ministrinë, për të zhvilluar politikën e punës, përpilimin dhe zbatimin e legjislacionit për një sistem jodiskriminues dhe të përgjegjshëm të kujdesit shëndetësor si dhe me paragrafin (ii) që e autorizon Ministrinë të bashkërendoj ofrimin e aktiviteteve në sektorin e shëndetësisë në mënyrë që të perparojë zhvillimin koherent të politikës së kujdesit shëndetësor;

Bazuar në nevojën për zbatimin adekuat të Ligjit për Shëndetësi të Kosovës;

E vendosur që të siguroj cilësinë e lartë të Sistemit të Informimit në Shëndetësi;

Duke marrë parasysh nevojën për sigurimin e të dhënave kualitative lidhur me aktivitetet shëndetësore, burimet njerëzore, aspektet financiare, kualitetin e shërbimeve si dhe pajisjet ekzistuese;

Me qëllim të shfrytëzimit efikas të burimeve ekzistuese institucionale dhe njerëzore në shëndetësinë e Kosovës;

Shpall si vijon:

Udhëzimin Administrativ (shëndetësi) 18/2006
PËR DATABAZËN E SISTEMIT TË INFORMIMIT SHËNDETËSOR

Dispozitat e përgjithshme

Neni 1

Sistemi i informimit shëndetësor (në tekstin e mëtejshëm, SISH) është:

- shërbim më rëndësi të veçantë që siguron të dhëna për hulumtime statistikore më interes për tërë vendin, të cilat shfrytëzohen për përcjelljen dhe hulumtimin e gjendjes shëndetësore të popullsisë, për programim dhe planifikim, për ndërmarrjen e masave të nevojshme në lëmin e kujdesit shëndetësor, për nevojë të hulumtimeve shkencore, për nevoja të sigurimit shëndetësor, për informimin e opinionit, për realizimin e obligimeve ndërkombetare nga lëmi i shëndetësisë si dhe nevoja të tjera;
- Sistem unik i informimit, pjesë përbërëse të të cilit janë të gjitha institucionet shëndetësore në territorin e Kosovës, të sektorit publik dhe privat, në të gjitha nivelet e kujdesit shëndetësor;
- Sistem i pandashëm me organizim vertikal dhe horizontal ndaj të cilit kanë përgjegjësi të gjitha institucionet shëndetësore pa marrë parasysh ndarjen rajonale dhe administrative;
- Njësi organizative e obliguar për të gjitha institucionet shëndetësore në Kosovë;

Qëllimi

Neni 2

Qëllimi i këtij Udhëzimi Administrativ është që të rregullojë mënyrën e operacionalizimit të Bazës qendrore të të dhënave-Databazës Qendrore (master database) të Sistemit të Informimit Shëndetësor si dhe Bazave lokale të të dhënave (local database) të Institucioneve shëndetësore publike për menaxhim kualitativ, të shpejtë dhe efikas të shërbimeve shëndetësore.

Përkufizimet

Neni 3

1. Databaza e Sistemit Informativ Shëndetësor (tutje: DB/SISH-03) është mbledhja, përpunimi dhe analiza e të dhënave për shëndetin dhe të dhëna tjera, të regjistruara në formë standarde në databazë, për qëllime të procesimit dhe si burim i informacionit
2. Të dhënat personale, janë të dhënat të cilat identifikojnë personin
3. Kodimi është transformimi i fjalëve ose numrave në një seri simbolesh
4. Të dhënat shëndetësore, paraqesin informata personale për shëndetin fizik, mental ose paaftësinë e një individi
5. DB/SISH-03 është emërtimi i Databazës së Sistemit të informimit shëndetësor

Administrimi i DB/SISH-03

Neni 4

- 4.1 DB/SISH-03 është pronë e Ministrisë së Shëndetësisë e cila administrohet nga Instituti Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (tutje: IKSHPK) dhe Departamenti i Informimit Shëndetësor (tutje:DISH).
- 4.2 DB/SISH-03 është aplikacion zyrtar i Ministrisë së Shëndetësisë i obligueshëm për të gjitha institucionet shëndetësore publike në territorin e Kosovës.
- 4.3 DB/SISH-03 operon në të tre gjuhët zyrtare (shqipe, angleze dhe serbe)

Lokacioni (Vendndodhja)

Neni 5

- 5.1 Baza qendrore e të dhënave të DB/SISH-03 është e vendosur në IKSHPK në Prishtinë, ndersa Backup-i në Ministrinë e Shëndetësisë.
- 5.2 DB/SISH-03 rajonale janë të vendosura në ISHP rajonale
- 5.3 DB/SISH-03 lokale është e vendosur në Njësinë e SISH në institucionin shëndetësor.
- 5.4 DB/SISH-03 veprimtarinë e vet e zhvillon në Kosovë dhe nuk mund të bartët jashtë territorit të Kosovës.

Komunikimi në mes të niveleve të DB/SISH-03

Neni 6

DB/SISH-03 operon në tre nivele: lokal, rajonal dhe qendror. Komunikimi në mes të këtyre niveleve realizohet në përputhje me mundësitë dhe të arriturat teknologjike. Kopjimi i të dhënave nga bazat lokale dhe dërgimi i tyre në bazen rajonale dhe atë qendrore në IKSHPK bëhet duke shfrytëzuar medime të ndryshme (CD, Flash etj) për çdo muaj me së largu deri me dt. 5 të muajit vijues, pos në rastet kur definohen në mënyrë të veçantë.

Shfrytëzimi i të dhënave nga DB/SISH-03

Neni 7

- 7.1 DB/SISH-03 përmban të dhëna të cilat përmes procesimit statistikor do të shfrytëzohen për përpilimin e Raporteve periodike shëndetësore, planifikim, udhëheqje të politikave dhe vendim-marrje.
- 7.2 Raporti në letër më të dhënat personale-shëndetësore të klientit nga DB/SISH-03 mund të ofrohen me parashtrimin e kërkesës zyrtare me shkrim nga personat fizik dhe juridik.
- 7.3 Kërkesa për raportin në letër me të dhënat personale-shëndetësore duhet të shqyrtohet brenda 15 ditësh nga dita e parashtrimit të saj. Në rast të refuzimit (sipas nenit 8 të Ligjit Nr. 2003/12 për Qasje në Dokumentet Zyrtare), personi përgjegjës i institucionit përkatës duhet ta informojë me shkrim parashtruesin e kërkesës mbi arsyeshmërinë e refuzimit të kërkesës.
- 7.4 Pala, në rast të refuzimit të kërkesës së tij ka të drejtë që të bëjë kërkesë të re brenda 15 ditësh nga data e marrjes së përgjigjës me shkrim dhe të kërkojë nga organi përkatës rishqyrtimin e vendimit. Nëse përgjigjja prapë është negative atëherë pala ka të drejtën që t'i drejtohet gjykatës kompetente me kërkesë për nisjen e procedurës gjyqësore kundër institucionit përkatës.
- 7.5 Raporti më të dhënat personale-shëndetësore të klientit mund të kërkohen edhe nga punëtorët shëndetësor të licencuar, në rast të kontrollit ose spitalizimit të përsëritur për arsye të trajtimit të mëtutjeshme.
- 7.6 Të dhënat e regjistruara ose të fituara me procesim nga DB/SISH-03 duhet të shfrytëzohen për avansimin ose zhvillimin e metodave të reja për përmirësimin e shëndetit, parashikimin, diagnostifikimin dhe trajtimin e sëmundjeve si dhe hulumtimin e mënyrave me kost-efektive të veprimtarisë të institucioneve shëndetësore, pos në rastet kur definohen në mënyrë të veçantë.